

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë; nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Mediha Jusufi e Ramë Hyseni, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësit-të kundër paditurit D.I. nga Gjilani, i përfaqësuar nga Sh.I. av. në Gjilan, kundër të paditurës-kundër paditëses A.Rr., nga fshati ... Komuna e Gjilanit, e përfaqësuar nga F.B. av. në Gjilan, për besimin e kujdesit prindëror të fëmijës, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.930/14 të dt. 25.10.2016, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë 12.Qershor.2017, jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të paditurës-kundër paditëses av. Faruk Brestovci dhe **Vërtetohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.930/14 i dt. 25.10.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin C.nr.930/14 të dt. 25.10.2016, ka vendosur si vijon:

I.” Aprovohet, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit- kundër të paditurit D.I. nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, e ushtruar ndaj të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, ashtu që fëmija i mitur ... i lindur me datë 17.05.2010 në Gjilan, nga i ati D.I. dhe nëna A.I. e lindur Rr., i besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim paditësit- të kundër paditurit D.I. nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit.

II. Aprovohet, si e bazuar pjesa e kërkesëpadiës së paditësit –kundër të paditurit D.I. ashtu që detyrohet, paditësi- i kundër padituri D.I. që të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr., t’ia lejojë kontaktin me fëmijën e mitur ..., i lindur me datë 17.05.2010 në Gjilan, të Premten e parë dhe të tretë të çdo muaji. Kontakti i lartcekur do të realizohet në këtë mënyrë, paditësi kundër i padituri D.I. detyrohet që të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr., t’ia dorëzon fëmijën e mitur ... të Premten në ora 15:00, kurse e paditura-kundër paditësja A.I. e lindur Rr. detyrohet që fëmijën e mitur ... t’ia kthejë paditësit-kundër të paditurit D.I. të Dielën në ora 15:00.

III. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e të paditurës-kundër paditëses A.I., e lindur Rr., nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, në të cilën ka kërkuar që fëmija i mitur ... i lindur me datë 17.05.2010 në Gjilan, t’i besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim, të paditurës-kundër paditëses Almedina Isurfi e lindur Rr..

IV. Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadiës së të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr., me të cilën ka kërkuar që paditësit-kundër të paditurit D.I. nga Gjilani, t’i

lejohej kontakti me fëmijën e mitur ... të premtën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ashtu që i njëjti kontakt të realizohet në atë mënyrë që e paditura-kundër paditësja do të detyrohej që fëmijën e mitur ..., t'ia dorëzoj paditësit-kundër të paditurit të premtën në ora 15:00, kurse paditësi-kundër padituri do të detyrohet t'ia kthej të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr. të dielën në ora 15:00.

V. Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësi- kundër i padituri D.I. që në emër të alimentacionit për mbajtjen e fëmijës së mitur ..., t'ia paguaj të paditurës-kundër paditëses A.I. e lindur Rr., për çdo muaj shumën prej nga 100 euro, duke filluar nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

VI. Detyrohet e paditura-kundër paditësja që paditësit-kundër të paditurit D.I. në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumën prej 644 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i të paditurës-kundër paditëses A.I., av. F.B. me dt. 25.11.2016, ka paraqitur ankesë me të cilën ka kërkuar që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin ankimor ashtu që fëmija i mitur ..., të i besohet në ruajtje përkujdesje dhe edukim, të paditurës-kundër paditëses A.I., duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.*

Përgjigje në ankesë është paraqitur.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit: kolegji, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet: 17, 18 e 19 të Ligjit për gjykatat, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 79/2010).

Vlerësimi i ankesës: Kolegji konstatojë në bazë shkresave të lëndës (flet kthesa për dorëzimin e aktgjykimit dhe shenja e vulës së pranimit e dhënë nga gjykata kompetente në kopjen e ankesës) se ankesa është paraqitur në afat ligjor, është e lejueshme dhe e plotë, pra i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176, 178 dhe 186 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 38/08), i datës 20 shtator 2008, i cili ka hyrë në fuqi me 6 tetor 2008 (më tej LPK).

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194, të LPK-së, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, dhe gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore, të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par. 2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedurale që do të ishin me ndikim në vendimmarrje të drejtë në këtë çështje kontestimore.

Nga shkresat në lëndë rezulton se Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, ka vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të dhënë me aktvendimin AC.nr. 4506/2014 të dt. 18.12.2014 ashtu që ka marr mendimin e Qendrës për Punë Sociale-Organit të Kujdestarisë në Gjilan, në seancë gjyqësore e ka dëgjuar përfaqësuesin e QPS-së, ka marr mendimin e ekspertit – psikologut S.H., si dhe prova tjera, dhe ka konstatuar se interesi më i mirë i fëmijës është që të jetë në kujdes prindëror të babai i tij D.I..

Qendra për Punë Sociale-Organit të Kujdestarisë në Gjilan, si organ profesional dhe kompetent, në raportin me shkrim, Nr.05-2558 të dt.21 10 2013 dhe të dt. 16 o7 2015 si dhe përfaqësuesi i saj në seancën gjyqësore, kishin rekomanduar që fëmija ..., t'i besohet në ruajtje, përkujdesje mbikëqyrje, babait të tij D.I. sepse: *“Fëmija, nga prindi babai dhe anëtarët tjerë të familjes ka kujdesin e duhur, duke i ofruar të gjitha kushtet e nevojshme për rritjen e zhvillimin e tij si fëmijë normal,”* Andaj, komisioni kompetent, kishte vlerësuar se fëmija të mbetet edhe më tutje nën përkujdesjen e babait D.I. meqë prej ndarjes ka qenë nën përkujdesjen e tij, anëtarëve tjerë të familjes Isufi, pastaj lidhjet me moshatarët, rrethin ku jeton *dhe çdo ndryshim dhe largimi i tij nga familja ku ka jetuar deri më tani do të ndikonte negativisht në zhvillimin e tij psiko-fizik, si dhe të formimit të një personaliteti-anëtari të dobishëm si për familjen dhe shoqërinë në tërësi.*

Psikologu S.H., me rastin e dhënies së mendimit me shkrim (Raporti i dt. 01.07.2014) dhe në seancë gjyqësore (Me dt. 22.07.2016) ka vlerësuar se ndryshimi i ambientit nga ai i krijuar te babai i tij, për Eldin, do të ketë bukur vështirësi për ri adoptim me situata të reja.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike në bazë të mendimit të organit kompetent të kujdestarisë si dhe ekspertit-psikologut kompetent dhe provave tjera shkresore, duke i dëgjuar edhe palët procedurale, kur ka vlerësuar, se ***interesi më i mirë i fëmijës*** është që kujdesi prindëror, ndaj fëmijës ..., t'i besohet babait të tij D.I..

Në bazë të gjendjes së konstatuar faktike të vërtetuar drejtë dhe plotësisht, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, sepse me nenin 140 par.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, është përcaktuar : *“Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e cekur në paragrafin (1) ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë: që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim te njëri prind, që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi të tretë.”*

Andaj, kolegji vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë i shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, është i bazuar në ligj dhe i drejtë, ndërsa e paditura – kundër paditësja deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes së shkallës së parë, e as në procedurë sipas ankesës, nuk arriti të provoj se gjykata e shkallës së parë nuk i ka hetuar drejtë dhe plotësisht të gjitha faktet dhe rrethanat që janë me ndikim vendimtar për të përcaktuar interesin më të mirë të fëmijës, që t'i besohet në kujdes prindëror babait të tij.

Më sa u tha më lartë, kolegji, vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 200 të LPK-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA. nr.4736/2016 dt. 12.Qershor.2017

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari,
Gani Avdiu